

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI  
PËR SEKTORIN E ENERGJISË**

**NDËRMJET**

**MINISTRISË SË EKONOMISË  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**DHE**

**MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë, më poshtë referuar si “Palët”,

**DUKE IU REFERUAR** partneritetin strategjik midis dy vendeve dhe bashkëpunimit dypalësh ndër sektorial;

**DUKE PASUR PARASYSH** rëndësinë e sigurisë së furnizimit me energji për zhvillimin ekonomik në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë;

**DUKE PASUR PARASYSH** mungesën e kapaciteteve gjeneruese dhe llojshmërinë e tyre në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë;

**DUKE PASUR PARASYSH** kushtet e favorshme të vendeve për zgjerimin e bashkëpunimit energjetik në lidhje me vendndodhjen gjeografike dhe marrëdhëniet tradicionale midis dy vendeve;

**DUKE THEKSUAR** rëndësinë dhe përfitimet e bashkëpunimit dypalësh në sektorin e energjisë dhe burimet energjetike në përfitim reciprok në përputhje me parimet e legjislacionit të BE-së dhe Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë, palë nënshkruese e të cilit janë Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë;

**DUKE PASUR PARASYSH** aspiratat e tyre për të përmirësuar dialogun dypalësh në të gjitha nivelet dhe rëndësinë e dialogut të tillë për zbatimin e politikave të përbashkëta për energjinë dhe burimet e energjisë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përpjekjet kundër ndryshimit klimatik.

Palët bien dakord si në vijim:

## Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është që Palët të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre dypalësh në sektorin e energjisë në përputhje me politikat dhe strategjitë e tyre.
2. Palët përcaktojnë fushat prioritare të bashkëpunimit si më poshtë: sektori i energjisë elektrike, thëngjilli, gazi natyror, burimet e ripërtëritshme të energjisë, eficientia e energjisë, siguria e furnizimit, si dhe përgatitja e projekteve relevante infrastrukturore të interkoneksionit për energji elektrike, si dhe nisma të tjera të projekteve. Me marrëveshje reciproke, palët mund të negociojnë çështje të tjera të rëndësishme me interes të ndërsjellë siç janë: bashkëpunimi në planifikimin e përbashkët të sistemit energjetik, përfshirë bilancin e përbashkët të energjisë elektrike dhe planifikimin e kapaciteteve gjeneruese, shqyrtimi i mundësive për investimet të përbashkëta gjeneruese dhe projekte të tjera infrastrukturore në fushën e energjisë.
3. Përderisa vazhdon kriza energjetike në rajon dhe Evropë dhe pritet të këtë vështirësi në furnizim gjatë dimrit, udhëzohen operatorët publikë të gjenerimit KEK dhe KESH të bashkëpunojnë në shkëmbimin dhe optimizmin e portfolios së energjisë elektrike ndërmjet dy ndërmarrjeve për të mundësuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike për të dy vendet tona, dhe tejkalimin sa më të lehtë të krizës energjetike.
4. Gjithashtu të dy TSO-të do të bashkëpunojnë me operatorët përkatës për të mundësuar shkëmbimin e tepriceve të energjisë ndërmjet dy vendeve.
5. Duhet lehtësuar/shtyrë tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet prodhuesve publik dhe TSO-ve për nevoja të sigurimit të shërbimeve ndihmëse si për kapacitetin balancues, ashtu edhe për energjinë balancuese si dhe humbjet e sistemit, në mënyrë që TSO-të të sigurojnë operimin të qëndrueshëm dhe të besueshëm të sistemit elektroenergjetik si dhe të mundësohet balancim i sistemit në kohë reale.
6. Marrëveshja e shkëmbimit të energjisë elektrike ndërmjet KEK dhe KESH, detajet teknike dhe tregtare do të jenë pjesë e marrëveshjes mes operatorëve.
7. Të dy vendet do të ndihmojnë operacionalizimin sa më parë të bursës së energjisë elektrike ALPEX dhe ndërlidhjen e këtij tregu me bursat tjera rajonale.
8. Palët do të shkëmbejnë informacione rreth sektorëve të tyre të energjisë, duke përfshirë zhvillimin e politikave të tyre të energjisë, harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me atë të Bashkimit Evropian, si dhe prioritetet e përshkruara në paragrafin 2 të këtij neni.
9. Palët do të mbështesin punën dhe përpjekjet e institucioneve të tyre të energjisë për të inkurajuar zhvillimin dhe bashkëpunimin në sektorin e energjisë dhe çështjet e lidhura me to. Afatet dhe kushtet përcaktohen nga institucionet dhe kompanitë e përfshira drejtpërdrejtë në përputhje me legjislacionin vendor dhe praktikën evropiane.

## **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Për përmbushjen e qëllimeve të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, Palët, në veçanti, do të:

1.1. Ndajnë përvojat dhe praktikat e tyre më të mira dhe do të krijojnë një mekanizëm për shkëmbim të rregullt të informacionit, si dhe do të mbajnë konsultime (relevante);

1.2. Inkurajojnë dhe mbështesin marrëdhëniet ndërmjet kompanive nga të dyja vendet përmes nxitjes së veprimtarive të biznesit në fusha të ndryshme energjetike, duke përfshirë përfaqësime të biznesit, seminare, panairë dhe ekspozita, bashkëpunim ndërmjet shoqatave të sektorit dhe organizimeve të tjera.;

1.3. Shkëmbejnë informacione dhe zotohen në zbatimin e programeve dhe projekteve të energjisë të cilat do të jenë me interes të përbashkët, duke përfshirë edhe interesin ndaj vendeve të treta;

1.4. Përcaktojnë masat për përmirësim të mëtejme të bashkëpunimit energjetik.

## **Neni 3 Bashkëpunimi**

1. Palët bien dakord të formojnë një ekip të përbashkët operativ të ekspertëve nga të dy ministrinë dhe përfaqësuesit e kompanive të tyre kombëtare, duke përfshirë, sipas nevojës, përfaqësuesit e ministrive dhe autoriteteve të të dy vendeve, për asistencë, konsultime mbi propozimet për hapa të mëtejshme në bashkëpunimin për zbatimin e fushave të rëna dakord sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

2. Secila Palë do të emërojë Koordinatorin dhe përfaqësuesit e ekipit të saj dhe do ta njoftojnë Palën tjetër me shkrim lidhur me këtë, brenda një (1) muaji pas nënshkrimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

3. Puna e ekipit do të bashkë kryesohet nga koordinatorët.

4. Ekipi do të takohet së paku një herë çdo gjashtë (6) muaj, me rotacion në çdo vend.

5. Subjektet afariste, që punojnë në projektet për bashkëpunim brenda fushëveprimit të këtij Memorandumi, mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e ekipit të ekspertëve.

6. Pala pritëse do të përgatis procesverbalin e çdo takimi, që do të nënshkruhet nga koordinatorët e ekipit, në fund të takimit.

#### **Neni 4 Interpretimi**

Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk do të interpretohet si krijim i marrëdhënie juridike midis Palëve. Rrjedhimisht, asnjëra Palë nuk mund ta zotojë ose detyrojë Palën tjetër përveç nëse nuk autorizohet në mënyrë të veçantë me shkrim.

#### **Neni 5 Zbatimi**

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të zbatohet në përputhje me ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë dhe nuk paragjykon të drejtat dhe detyrimet e Operatorëve dhe as të Ministrive përkatëse sipas ligjeve të të dy shteteve.

#### **Neni 6 Gjuha**

Ky memorandum është hartuar në gjuhë shqipe dhe nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale.

#### **Neni 7 Hyrja në fuqi**

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij. Memorandumi mbetet në fuqi për një periudhë prej dy (2) vitesh pas hyrjes në fuqi dhe do të zgjatet automatikisht për periudha të njëpasnjëshme dyvjeçare (2), përveç nëse njëra Palë njofton Palën tjetër për tërheqje nga Memorandumi i Mirëkuptimit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të çdo periudhe (2) dyvjeçare.
2. Ky Memorandum mund të ndryshohet në çdo kohë me marrëveshje reciproke me shkrim të të dyja Palëve. Ndryshimet e rena dakord hyjnë në fuqi në datën që të dyja palët kanë rënë dakord për një gjë të tillë me shkrim.
3. Palët do të kenë të drejtën të ndërpresin këtë Memorandum të Mirëkuptimit duke i dërguar një njoftim paraprak me shkrim pas një paralajmërimi prej tridhjetë (30) ditësh.

Bërë në Prishtinë, më 20 qershor 2022.

Ministria e Ekonomisë e Republikës  
së Kosovës

**Artane Rizvanolli**

*A. Rizvanolli*  
Ministre e Ekonomisë

Ministria e Infrastrukturës dhe  
Energjisë të Republikës së Shqipërisë

**Belinda Balluku**

*Belinda Balluku*  
Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë